



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.746/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Afijete Sada - Glllogjani dhe Ferki Xhaferi anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur lidhur me apelet e Visar Hoti, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, me të cilat ka kërkuar rinumërim të votave në vendvotimet e apeluara, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 06.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen të pabazuara apelet Anr.746/2021, 747/2021, 748/2021, të datës 05.03.2021, të paraqitur nga Visar Hoti, kandidat për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021.

A r s y e t i m

Me datë 05.03.2021, kandidati për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Visar Hoti, ka paraqitur në PZAP, apelet Anr.746/2021, 747/2021, 748/2021, me të cilat me apelin Anr.746/2021, pretendon se pas shpalljes së rezultateve nga KQZ është vërejtur se në kutinë numër 1815E/01R i figurojnë vetëm 4 vota, kurse nga FRK numër 1815E/01R që posedon të cilën e ka marrë nga KQZ figurojnë 48 vota. Parashtruesi i apelit pretendon se pas rinumërimit të kësaj kutie, zyrtari i KQZ-së gabimisht ka vendosur shënimet në sistem dhe me këtë rast janë regjistruar 44 vota më pak. Lidhur me apelet Anr.747/2021 dhe Anr.748/2021, parashtruesi i apelit pretendon se në kutinë 1832E/02D dhe kutinë 1832E/01D në fshatin Sibofc i Epërm, në të gjitha vendvotimet në Podujevë ka marrë mbi 45% të votave të subjektit LDK, ndërsa në këtë vendvotim ka marrë vetëm 18%. Më tutje pretendon se nga interesimi i disa familjeve të mëdha të këtij fshati i kanë treguar se besimi i tyre është keqpërdorur ngase këto familje i kanë treguar se është shumë më shumë i votuar se sa figuron në FRK. Parashtruesi i apelit kërkon rinumërimin e këtyre vendvotimeve.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar

Paneli, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar apelet e lartcekura dhe i trajton si një apel i evidentuar me Anr.746/2021, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve dhe për apele që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato apele të trajtohen me një vendim i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apeleve në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë vetëm pretendime të tij, kjo rrjedhimisht sepse pritet e ankuesit për të marrë sa më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se medoemos ka edhe mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel për aq më tepër duke marrë për bazë faktin se votimi është i fshehtë dhe paraqet vullnetin e lirë të votuesit.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar nga Visar Hoti i subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.746/2021 më datën 06.03.2021

Kryesuesja e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.